



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 10 prill 2013
Nr. ref.:MPM406/13

Mendimi i përbashkët mospajtues i

Gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues

në

Rastin Nr. KO131/12

Parashtruesi

Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012

Në këtë rast, Parashtruesit pretendojnë që nenet 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 dhjetor 2012, nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Shumica e kësaj Gjykate ka vlerësuar që nenet 18, 19 dhe 60 të këtij Ligji janë në përputhje me Kushtetutën, por ka vlerësuar që neni 41 nuk është në përputhje me Kushtetutën. Shumica ka gjetur që neni 41 i këtij Ligji cenon nenin 49 të Kushtetutës. Ky qëndrim bazohet në interpretim të gabueshëm të Kushtetutës.

Neni 41 i ligjit të kontestuar përcakton se:

1. *Profesionisti shëndetësor i punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesshëm të punës, nuk ka të drejtë të punojë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.*

2. Është rreptësisht e ndaluar që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor tek institucionet private të kujdesit shëndetësor për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.
3. Ndalohet rreptësisht qfarëdo shpërblimi formal ose joformal, financiar ose i llojit tjetër i profesionistit shëndetësor përfshirë shpërblimin për referimin e qytetarit ose banorit nga sektori publik në sektorin privat të shëndetësisë, dhe marrëdhëniet profitabile me industrinë farmaceutike.
4. Shkelësit e dispozitave të këtij neni do të jenë subjekt i dënimeve ose veprimeve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe aktin e veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.
5. Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë t'i lejojnë punëtorët e tyre shëndetësorë të ushtrojnë aktivitetet e tyre private shëndetësore brenda institucionit publik shëndetësor.
6. Aktiviteti privat shëndetësor nga paragrafi 5 i këtij neni do të implementohet në bazë të një akti të veçantë nënligjor që nxirret nga Ministria.

Edhe pse neni 41 përcakton disa kufizime për profesionistët shëndetësorë që punojnë në institucion publik, ai në mënyrë specifike i lejon profesionistët shëndetësorë që të ushtrojnë aktivitete private shëndetësore në një institucion publik.

Neni 41 vendos tri kufizime për profesionistët publikë të shëndetësisë:

- (1) Nëse jeni profesionist shëndetësor i punësuar në sektorin publik, nuk lejoheni të punoni në institucion privat shëndetësor;
- (2) Nëse doni t'i referoni pacientët nga institucioni shëndetësor publik i kujdesit dytësor dhe tretësor tek një institucion shëndetësor privat, duhet t'i artikulonit arsyet e bazuara mjekësore për një referim të tillë;
- (3) Nuk mund të merrni kompensim financiar për referimin e pacientit tek një institucion privat shëndetësor.

Parashtruesit pohojnë se ky nen cenon nenin 49 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit. Neni 49 përcakton se:

- “1. E drejta e punës garantohet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.”

Çështja në këtë Gjykatë është nëse neni 41 i Ligjit privon ndonjë qytetar nga e “drejta për punë” apo e drejta “për zgjedhjen e profesionit dhe vendit të punës”. Nuk e privon askënd nga e drejta për të punuar apo për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës.

Neni 41 nuk e ndalon askënd që është i kualifikuar përshtatshëm sipas arsimimit, trajnimit dhe testimit që të shërbejë si profesionist shëndetësor, ose në sektorin publik ose në atë privat. Në fakt, në përputhje me nenin 51 të Kushtetutës, ky ligj përmbush mandatin e Kushtetutës që kujdesi shëndetësor rregullohet me ligj. Ligji e bën këtë duke provuar të ndalojë punësimin e njëkohshëm në të dy sektorët, ashtu që të mos ketë as konflikt interesash, e as paraqitje të konfliktit të interesave në anën e profesionistëve shëndetësorë, si dhe ashtu që cilësia e kujdesit shëndetësor e ofruar në sektorin privat dhe atë publik të mund të jetë relativisht e njëjtë.

Secili punëdhënës ka të drejtë të vendosë kufizime ndaj të punësuarve të vet në kuptimin e asaj se si punëtorët kryejnë detyrat e veta për punëdhënësin, si dhe nëse ata mund të kenë punësim shtesë të njëkohshëm. Për shembull, zyrtarët publikë të policisë mund të ndalohen nga ushtrimi i profesionit të zyrtarit privat të sigurisë, sepse ato role të njëkohshme mund të jenë në konflikt mes vete. Gjyqtarët e kanë të ndaluar të angazhohen në shumë lloje tjera të punëve derisa shërbejnë si gjyqtarë. Në fakt, vetë Kushtetuta i ndalon kandidatëve për deputetë në Kuvend të mbajnë vende të ndryshme të tjera të punës. Neni 73 përcakton se:

“1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:


- (1) gjyqtarët dhe prokurorët;*
- (2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;*
- (3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;*
- (4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;*
- (5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;*
- (6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;*
- (7) përfaqësuesit diplomatikë;*
- (8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.

3. Kryetarët dhe zyrtarët tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.”

Asnjë prej këtyre kufizimeve nuk e privon askënd nga e drejta për të punuar ose për të zgjedhur profesionin e tij/saj të punës. Ato thjesht përcaktojnë disa prej kualifikimeve për kryerjen e punës. Neni 41 thjesht provon të minimizojë në mënyrë proporcionale secilin konflikt interesi apo paraqitjen si të tillë të një profesionisti shëndetësor që zgjedh të punojë në sektorin publik. Ai gjithashtu tenton ta bëjë më të barabartë cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga sektori publik dhe ai privat. Gjykata nuk mund ta përcaktojë nëse nëse neni 41 do të përmbushë ato synime. Ai funksion është përgjegjësi e vetme e deputetëve të Kuvendit që zgjidhen nga qytetarët e Kosovës. Gjykata Kushtetuese vetëm duhet të vendosë nëse neni 41 cenon nenin 49 të Kushtetutës. Nuk e cenon.

Dorëzuar me respekt


Gjyqtari Robert Carolan




Gjyqtari Almiro Rodrigues